

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

L I G J

Nr.9426, datë 6.10.2005

PËR MBARËSHTIMIN E BLEGTORISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:
K R E U I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja, përmirësimi dhe ruajtja e cilësive të burimeve gjenetike shtazore, me synim nxitjen e fermerëve për shtimin e prodhimeve blegtorale, përmirësimin e cilësisë së produkteve shtazore dhe ruajtjen e ndryshueshmërisë gjenetike të kafshëve të fermës.

Neni 2

Objekti dhe fusha e zbatimit të ligjit

1. Objekt i këtij ligji janë përcaktimi i kushteve dhe praktikave blegtorale, për një mbarështim të mirë të kafshëve në fermë, metodat dhe teknologjitë e mbarështimit të kafshëve, baza ushqimore, kushtet për hartimin dhe miratimin e programeve racore, ndryshimet dhe ruajtja e cilësive të blegtorisë, ruajtja e ndryshueshmërisë gjenetike, gjenofondet dhe racat autoktone, shërbimet profesionale në blegtori, banka gjenetike për kafshët, organizatat e mbarështuesve të kafshëve, trajnimi në blegtori, tregu dhe tregtimi i materialeve racore, inspektimi zooteknik dhe fondet e nevojshme për këtë qëllim.

2. Ky ligj zbatohet për gjedhët, buajt, njëthundrakët, derrat, dhentë, dhitë, lepujt, shpendët, bletët dhe krimin e mëndafshit, në vazhdim të përmendur si “kafshët e fermës”, dhe për kafshët e egra, që janë subjekt i mbarështimit.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

1. “Raca autoktone” janë racat e kafshëve të fermës, me origjinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. “Bioteknologjitë shtazore” janë të gjitha metodat bioteknologjike dhe/ose procedurat e lejuara në mbarështimin e kafshëve të fermës.
3. “Provat biologjike” janë provat, që përcaktojnë frekuencën e gjeneve specifike, në përputhje me rregulloret dhe programet racore.
4. “Biodiversiteti në kafshët e fermës” është varieteti i jetës në të gjitha format e saj, i përbërë nga diversiteti gjenetik i specieve, që u përket kafshëve të fermës.
5. “Kullotë mjaltëdhënëse” është territori, në të cilin kullotja e bletëve bëhet në mënyrë të organizuar, në përputhje me rregullat e shfrytëzimit të burimeve të mjaltit.
6. “Tërësia e gjeneve” është i gjithë informacioni gjenetik për një individ pjellor në një popullatë, që riprodhohet seksualisht.
7. “Praktika të mira në mbarështimin e kafshëve” janë praktikat e rritjes së kafshëve të fermës, në mënyrë të tillë që sigurojnë mirëqenien e tyre. Kjo praktikë, sipas parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, mban dhe merr parasysh cilësitë natyrore të zonës bujqësore, siguron pjellorinë e përhershme të tokës dhe prodhimin e produkteve blegtorale të sigurta.
8. “Kafshët e fermës” janë kafshët, që rriten nën mbrojtjen dhe kujdesin e njeriut, për t’u përdorur prej tij.
9. “Standardet ekologjike” janë nivelet maksimale të lejuara të ndotjes mjedisore për rritjen e kafshëve të fermës.
10. “Proceset dhe sistemet ekologjike” janë mekanizmat natyrorë të ndërvarësisë ndërmjet organizmave dhe mjedisit të tyre.
11. “Standardet etologjike” janë kërkesat minimale, që lejojnë sjelljen karakteristike të specieve dhe mirëqenien e kafshëve të fermës.
12. “Përmirësimi gjenetik” është ndryshimi i një popullate, si rezultat i përmirësimit të tipareve të trashëgueshme të kafshëve të fermës.
13. “Vlera gjenetike e një kafshe” është vlera e shprehur e gjenotipit të vetë kafshës.
14. “Rezervë gjenetike” është numri minimal i kafshëve të të dyja seksëve, doza e spermës, vezët dhe embrionet, që mbahen në ruajtje për qëllime të programit racor, për të siguruar ndryshueshmërinë e vazhdueshme gjenetike për çdo racë të veçantë dhe riprodhimin e kafshëve të fermës në rrethana të veçanta.
15. Ndryshueshmëri gjenetike” është shumëllojshmëria e tërësisë së gjeneve.
16. “Bankë gjenetike” është mjedisi ku ruhet dhe mbahet nën kontroll materiali racor për zhvillimin e ndryshueshmërisë së formave të jetës.
17. “Prova e gjeneve” është përcaktimi i pranisë së një gjeni të caktuar te kafsha.
18. “Njësi gjedhi” është një njësi blegtorale krahasimi, ndërmjet specieve dhe kategorive të kafshëve të fermës, që merr për bazë një lopë qumështi me rendimet 4 000 litra qumësht, me 4 për qind yndyrë.
19. “Ndërzim i lirë” është çiftëzimi i pakontrolluar i kafshëve femra me një ose më shumë riprodhues meshkuj.
20. “Heterozis” është shtesa e pjellorisë, e rritjes, e vitalitetit dhe e cilësive të tjera të pasardhësve nga prindër gjenetikisht të ndryshëm.
21. “Regjistri i fermës” është një dokument i përcaktuar, që përmban informacionin për kafshët e fermës agrolektorale.
22. “Fermer” është personi fizik ose juridik, që ka në pronësi dhe/ose kujdeset për kafshët e fermës.
23. “Fermë agrolektorale” është vendi i mbajtjes dhe i kujdesit për kafshët e fermës, sipas praktikave të mira të mbarështimit.
24. “Kryqëzimi i kafshëve të fermës” është çiftëzimi i kafshëve me seks të kundërta.
25. “Spermë e përzier” është sperma e bashkuar e dy ose më shumë riprodhuesve meshkuj të së njëjtës specie.

26. “Qendër e prodhimit të spermës” është njësia e miratuar për prodhimin e spermës, e cila mban dhe/ose shfrytëzon riprodhues për vjeljen, përpunimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e spermës.

27. “Kujdesi për kafshët” është sigurimi i strehimit, ushqimit, ujit, pastrimit dhe mëmëzimit të kafshëve të fermës, si dhe plotësimi i kushteve të tjera të mbarështimit, sipas rregulloreve në zbatim të këtij ligji.

28. “Rritës i kafshëve” është personi fizik, i cili kujdeset për kafshët e fermës.

29. “Bashkëgjakësia” është çiftëzimi i kafshëve të një gjaku, që kanë një paraardhës të përbashkët, të njohur.

30. “Riprodhuese” është një kafshë fermër e vlerësuar dhe e përzgjedhur, që plotëson të gjitha kërkesat e një programi racor të miratuar.

31. “Riprodhues” është një kafshë mashkull i vlerësuar, i përzgjedhur dhe i provuar, që plotëson të gjitha kërkesat e një programi racor të miratuar.

32. “Vlerë racore” është pjesa e vlerës gjenetike të kafshës, e cila u kalon pasardhësve.

33. “Material racor” është një kafshë race, spërma, ovulat, embrionet dhe vezët e shpendëve për çelje.

34. “Provë krahasuese” është procedura e zgjedhur për matjen dhe krahasimin e tipareve ndërmjet racave, linjave ose kryqëzimeve brenda së njëjtës specie të kafshëve të fermës, si dhe ushqimeve ose suplementeve ushqimore dhe pajisjeve.

35. “Tregtim” është shitja ose çdo transferim i pronësisë mbi kafshën, materialeve racore, produkteve të tyre dhe lëndëve të para te një person i tretë.

36. “Emër tregtar” është emri që përdoret për shpendët e racës, që rrjedhin nga një tufë e mbyllur dhe e përzgjedhur për të paktën pesë gjenerata. Pasardhësit e kryqëzimit të fundit mbajnë, gjithashtu, këtë emër.

37. “Popullata” është një grup kafshësh të fermës, që janë përfshirë në të njëjtin program racor.

38. “Dokumentacioni zooteknik” është tërësia e formularëve të miratuar, që përdoren në mbarështimin e kafshëve të fermës.

39. “Rritje” është mbajtja dhe kujdesi për kafshët e fermës, sipas praktikave të mira të mbarështimit.

40. “Mbarështimi i kafshëve” është rritja e kafshëve të fermës, në mënyrë të tillë që të sigurohet mirëqenia e tyre dhe mbështetet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, e cila mban dhe merr parasysh cilësitë natyrore të zonës bujqësore, që siguron pjellorinë e përhershme të tokës dhe prodhimin e produkteve blegtorale të sigurta.

41. “Mbarështues” është personi fizik ose juridik, i cili merret me mbarështimin e kafshëve të fermës dhe, zakonisht, është pronari i tyre.

42. “Programi racor” është dokumenti që specifikon racat ose një racë të veçantë, ku përcaktohen objektivat e mbarështimit, metodat e përdorura, masat e planifikuara për një mbarështim të mirë dhe një numër i caktuar kafshësh për zbatimin e suksesshëm të programit.

43. “Libër gjeneologjik” është baza e të dhënave, informacioni elektronik ose dokumente të shkruara, që përmbajnë të dhënat ose listën e kafshëve të racës, të cilat përmbushin kërkesat e përcaktuara në programin racor dhe që janë përzgjedhur si riprodhues.

44. “Metodat e përmirësimit racor” janë metodat e provës, të përzgjedhjes dhe plani i përdorimit të kafshëve të vlerësuara, të përzgjedhura dhe të provuara, me qëllim arritjen e objektivave racorë.

45. “Teknologjitë e mbarështimit” janë procedura teknike për rritjen dhe shfrytëzimin e kafshëve.

46. “Prova në kafshët e fermës” është praktika e matjes së tipareve dalluese të kafshëve të fermës.

47. “Stacion prove” është njësia e miratuar, ku kryhen prova krahasuese të tipareve dalluese të kafshëve të fermës për përzgjedhjen e riprodhuesve.

48. “Kafshë gjenetike të modifikuara (transgjenike) të fermës” janë kafshët, të cilave u është ndryshuar në mënyrë të përhershme tërësia e gjeneve, nëpërmjet shtesës, eliminimit apo këmbimit të gjeneve specifike dhe/ose elementeve të ADN-së.

49. “Kafshë të egra, të mbrojtura” janë kafshët e përcaktuara sipas ligjit nr.7875, datë 23.11.1994 “Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë”.

50. “Import” është çdo hyrje e materialit racor në pikat e kalimit kufitar doganor të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të hyrjeve për shkak të tranzitit dhe importeve të përkohshme për konkurse dhe panairë.

51. “Standardet zoohigjienike” janë kushtet minimale zoohigjienike për mbajtjen e kafshëve të fermës.

52. “Produkte me origjinë nga kafshët” janë qumështi, mishi, vezët, mjalti, leshi, mëndafshi dhe prodhime të tjera me origjinë nga kafshët e fermës.

53. “Burime gjenetike shtazore të fermës” janë speciet e kafshëve, që janë përdorur ose mund të përdoren për prodhimin e produkteve shtazore dhe/ose për qëllime të tjera në bujqësi.

54. “Identifikim” është vendosja e një numri dallues individual ose i shenjave të tjera, sipas një kodi të caktuar, kafshëve të fermës.

55. “Racë” është një nënspecie e kafshëve të fermës, fenotipike ose gjeografike, e karakterizuar nga një frekuencë gjenetike, e cila i dallon këto kafshë nga kafshët e tjera të së njëjtës specie.

56. “Linjë” është grupi i kafshëve të fermës, të cilat kanë një tipar ose disa tipare të përbashkëta, që i dallon ato nga kafshët e tjera të së njëjtës racë.

57. “Stacion i ndërzimit natyror” është njësi bujqësore me riprodhues meshkuj për çiftëzimin natyror të kafshëve femra të një ose disa fermave blegtorale.

58. “Fermë agrolegtorale me sistem të mbarështimit konvencional” është ferma agrolegtorale, që lejon zbatimin e sistemeve të përshtatshme të mbarështimit, kujdesit, ushqimit dhe stimuluesve të prodhimit.

59. “Fermë agrolegtorale me sistem të mbarështimit të integruar të kafshëve të fermës” është ferma agrolegtorale, që synon qarkullimin maksimal të balancuar të substancave, ku futja e tyre në qarkullim nuk mund ta kalojë nxjerrjen e përgjithshme të substancave prej kësaj zone.

60. “Fermë agrolegtorale me sistem të mbarështimit organik të kafshëve të fermës” është ferma agrolegtorale, e cila praktikon mbarështimin e kafshëve, sipas metodave dhe procedurave natyrore të përcaktuara në ligjin nr. 9199, datë 26.2.2004 “Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve BIO”.

61. “Qendra të prodhimit të kafshëve të racës” janë ferma agrolegtorale, stacione kërkimi dhe qendra industriale blegtorale, të specializuara për prodhimin dhe përhapjen e kafshëve me vlera të larta racore.

62. “Zhvillim i qëndrueshëm” është zhvillimi, që plotëson nevojat e së tashmes dhe të së ardhmes, pa shtrënguar ose prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm të plotësojnë nevojat e tyre.

KREU II

RRITJA E KAFSHËVE NË FERMË

Neni 4

Kushtet e mbarështimit

1. Mbarështimi i kafshëve të fermës kërkon plotësimin e nevojave biologjike, mosndërhyrjen në nevojat fiziologjike, respektimin e standardeve etologjike, mostejkalimin e

aftësive për përshtatje, trajtimin sipas rregullave për mbrojtjen e kafshëve, praktikave veterinare dhe plotësimin e nevojave për strehim.

2. Ushqimi i detyruar i kafshëve të fermës është i lejueshëm vetëm kur është i domosdoshëm për arsye shëndetësore ose për mbijetesën e tyre.

3. Transporti, therja dhe vrasja e kafshëve të fermës kryhet sipas rregullave zooteknike e veterinare dhe atyre për mbrojtjen e kafshëve, duke siguruar ruajtjen e cilësive të kafshëve dhe të prodhimeve blegtorale.

4. Rregullat e hollësishme për mbarështimin e kafshëve përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 5

Teknologjia e mbarështimit të kafshëve

Mbarështimi i kafshëve të fermës bëhet sipas teknologjive të mbarështimit, që plotësojnë standardet etologjike dhe që janë në përputhje me standardet ekologjike dhe me zhvillimin e qëndrueshëm të të gjitha formave jetësore.

Neni 6

Baza foragjere

1. Baza foragjere e prodhuar brenda vendit kultivohet, ruhet dhe përdoret sipas parimit të zhvillimit të qëndrueshëm.

2. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (më poshtë ministria) siguron monitorimin e vazhdueshëm dhe analizat e foragjereve të prodhuara, për përmirësimin e vlerës së tyre ushqimore.

3. Kushtet e hollësishme të teknologjive për ruajtjen dhe përdorimin e prodhimeve foragjere përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 7

Planifikimi i hapësirës për mbarështim

1. Planifikimi i hapësirës duhet të sigurojë mundësi për mbarështimin e kafshëve, në përputhje me qëllimin e mbajtjes së tyre.

2. Hapësira e planifikuar për mbarështimin e kafshëve, në çdo rast që në këto hapësira përfshihen toka bujqësore ose objekte agroblegtorale, që do të ndërtohen në tokë bujqësore, përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Kur për interes publik kërkohet që një objekti agroblegtoral t'i ndryshohet vendodhja nga ajo aktuale në një vendndodhje të re, autoriteti propozues siguron paraprakisht fondet respektive të lëvizjes së fermës agroblegtorale.

Neni 8

Mbarështimi i kafshëve në zonat e mbrojtura

Mbarështuesi i blegtorisë në një zonë me tokë bujqësore, të shpallur ose që shpallet zonë e mbrojtur, bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”.

Neni 9

Mbarështimi i mirë i kafshëve

1. Mbarështuesi i kafshëve ushtron mbarështimin e mirë të kafshëve të fermës në toka bujqësore dhe në strehime, që janë në pronësinë e tij ose të marra me qira dhe, në rastin e mbajtjes së bletëve, në toka bujqësore të pakultivuara, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj.

2. Kur pronari i tokës bujqësore ka dhënë në përdorim ose me qira tokën bujqësore për qëllime të mbarështimit të kafshëve, vlerësohen veprime të pranueshme në këto veprimtari të përdoruesit ose të qiramarrësit:

a) plehërimi dhe kultivimi i tokës, rritja dhe korrja e prodhimeve, mbarështimi i kafshëve;
b) përdorimi i tokës me kullotje, rritja e bletëve, ngjarje dhe veprimtari tradicionale vendore.

3. Për mbarështimin e mirë të kafshëve, mbarështuesi ka të drejtë:

a) ta rrethojë pronën dhe të rregullojë rrugëkalimet, në mënyrë që të mos i ndalojë të tjerët të ushtrojnë të drejtat e tyre ligjore;
b) të kërkojë kompensim për kafshët e fermës të humbura dhe prodhimin e humbur në bimët foragjere, shkaktuar nga kafshët e egra, të mbrojtura;
c) të kërkojë kompesim për mbrojtje dhe kujdes shëndetësor shtesë për kafshët e fermës, të dëmtuara nga kafshët e egra, të mbrojtura;
ç) të kërkojë kompesim nga shteti, sipas ligjit nr.9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”, në rast të masave parandaluese të urdhëruara për shkak të sëmundjeve të dyshuara të kafshëve;
d) të ndalojë hyrjen e kafshëve të fermave të tjera, të cilat nuk janë në pronësi të tij, në objektet e veta bujqësore, në tokën në pronësi të tij ose të marrë në përdorim a me qira.

Neni 10

Infrastruktura bujqësore

Mbarështimi i kafshëve kërkon infrastrukturë të përshtatshme bujqësore. Në infrastrukturën bujqësore përfshihen ndërtesat e fermës, në fushë ose në kullota, rrugët dhe rrugicat, gardhet kufizuese, uji dhe energjia. Rritësi ka të drejtë të ndërtojë dhe të përdorë infrastrukturën e nevojshme, që i siguron mbarështimin e mirë të kafshëve.

Neni 11

Kujdesi për kafshët e fermës

1. Kujdesi për kafshët e fermës bëhet në përputhje me rregullat zooteknike dhe veterinare për mbrojtjen e shëndetit të tyre. Parregullsitë ose mungesat në metodat e rritjes, që kanë efekt të dëmshëm në mirëqenien dhe shëndetin e kafshëve të fermës duhet të parandalohen dhe të eliminohen.

2. Rritësi i kafshëve siguron një trajtim dhe kujdes të përshtatshëm për kafshët e sëmura, të dëmtuara ose të vjetra të fermës dhe, nëse është e domosdoshme, një mjedis të izoluar, sipas rregullave të mbrojtjes veterinare, të përcaktuara në ligjin nr.9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”.

3. Gjatë mbarështimit dhe kujdesit për kafshët e fermës ndalohen veprimet ose mosveprimet, që mund të shkaktojnë dhimbje, vuajtje ose dëmtime të tyre.

Neni 12

Veprimtaritë teknike të mbarështuesve të kafshëve të fermës

1. Veprimtaritë teknike që ka të drejtë të kryejë vetë mbarështuesi i kafshëve të fermës janë:
 - a) dhënia e ndihmës së shpejtë kafshëve, si: shpim me troakar, termometrim, trajtim i plagëve, ndihmë gjatë pjelljes;
 - b) sterilizimi dhe kastrimi i kafshëve të reja;
 - c) përdorimi i suplementeve mineralo-vitaminike në ushqimin e kafshëve;
 - ç) prerja e bishtit të derrkucave dhe qengjave, e sqepit të shpendëve, e brirëve te ripërtypëset, heqja e dhëmbëve prerës të derrkucave;
 - d) trajtimi dhe kujdesi për thundrat dhe pastrimi i kafshëve;
 - dh) kontrolli i afshëve dhe bërja e çiftëzimit natyror;
 - e) matrikullimi i kafshëve të fermës për qëllime zooteknike, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj;
 - ë) përdorimi i preparateve farmakologjike, të lejuara pa recetë veterinare, dezinfektimi dhe luftimi i insekteve me preparate të lejuara në objektet agroblegtorale të mbarështimit të kafshëve;
 - f) qethja e bagëtive;
 - g) ushtrimi i veprimtarive për rritjen e bletëve dhe të krimbit të mendafshit.
2. Mbarështuesi i kafshëve të fermës duhet të ketë njohuri profesionale për mbarështimin, trajtimin dhe kujdesin shëndetësor të kafshëve të fermës, për kultivimin dhe manipulimin e foragjereve, ushqimin e kafshëve të fermës, për prodhimet blegtorale dhe trajtimin e plehrave.
3. Niveli i njohurive profesionale dhe i njohurive të tjera është në varësi të kompleksitetit të veprimtarive në mbarështimin e kafshëve dhe të kujdesit për to.

Neni 13

Të ushqyerit

1. Mbarështuesi i kafshëve të fermës u siguron kafshëve, rregullisht, ushqim të përshtatshëm me cilësi e sasi të mjaftueshme, furnizim me ujë dhe ajër, në mënyrë që të mbulojë mjaftueshëm nevojat e të ushqyerit dhe nevojat e tjera biologjike.
2. Çështjet e tjera për ushqimin e kafshëve përcaktohen në ligjin nr.8411, datë 1.10.1998 "Për ushqimet e blegtorisë".

Neni 14

Objektet e strehimit

Ferma agroblegtorale mund të ketë në përbërje të saj këto objekte:

- a) stalla, tenda, bokse, sallë mjeljeje, padoqe, rezervuarë uji, plehërishta dhe depo urine;
- b) objekte magazinimi për ruajtjen dhe përpunimin e ushqimeve, si: hangar bari, rrjeta për bar, kontenierë për drithë dhe qilarë;
- c) park për bletë, vaska dhe rezervuarë uji për rritjen e peshkut;
- ç) hangar për mjete bujqësore, mjedise të tjera për mbarështimin e kafshëve, si: kullota të rrethuara ose të parrethuara me bari elektrik ose gardhe, pista për stërvitjen e kuajve, vend ngarkimi dhe shkarkimi të kafshëve, pistë vrapimi, lera e hauze uji.

Neni 15

Madhësia e fermave

1. Sipas madhësisë, fermat ndahen në:

- a) ferma të mëdha agrolegtorale, që mbarështojnë mbi 50 njësi gjedhi të kafshëve të fermës në bazë ditore;
 - b) ferma të mesme agrolegtorale, që mbarështojnë nga 10 deri në 50 njësi gjedhi;
 - c) ferma të vogla agrolegtorale, që mbarështojnë më pak se 10 njësi gjedhi.
2. Mënyra e konvertimit të kafshëve të tjera në njësi gjedhi bëhet me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 16

Procedurat e ndërtimit të objekteve agrolegtorale

1. Para ndërtimit ose rindërtimit të një objekti agrolegtoral për fermat e mëdha, personat fizikë ose juridikë duhet të marrin miratimin e autoritetit kompetent në ministri për projektin teknologjik, i cili shoqërohet me propozimin e drejtorisë së bujqësisë dhe ushqimit të qarkut (më poshtë DBU). Projekti teknologjik për fermat e mesme dhe të vogla miratohet në DBU-në e qarkut.
2. Nëse objekti agrolegtoral plotëson kriteret tekniko-teknologjike, autoriteti kompetent lëshon lejen e ushtrimit të veprimtarisë për objektin agrolegtoral për fermat e mëdha. Për fermat e mesme dhe të vogla kjo leje lëshohet nga DBU-ja e qarkut.
3. Kriteret tekniko-teknologjike për ndërtesat, hapësirat dhe pajisjet e një objekti agrolegtoral të mbarështimit të kafshëve përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
4. Autoriteti kompetent në ministri mban Regjistrin Kombëtar të Fermave të Mëdha Agrolegtorale. Regjistri për fermat agrolegtorale të mesme dhe të vogla mbahet në DBU-në e qarkut.

Neni 17

Pajisjet për mbarështimin e kafshëve

1. Për sigurimin e një mbarështimi të mirë të kafshëve dhe të cilësisë së prodhimeve blegtorale përdoren pajisje të përshtatshme, sipas standardeve zoohigjienike dhe etologjike për strehimin, ushqimin, rezervën ujore, pastrimin dhe kujdesin, pajisje për rregullimin e kushteve mjedisore, lirinë e lëvizjes, pirjen e ujit, dhënien e ushqimeve dhe transportin e jashtëqitjeve të kafshëve.
2. Pajisjet e mbarështimit të kafshëve janë:
 - a) vendqëndrime të përshtatshme, bokse, pajisje për lidhjen e kafshëve, kafaze, dysheme stallash, objekte për pirjen e ujit;
 - b) pajisjet e përshtatshme për ndriçimin dhe ventilimin e duhur, zgjoje të përshtatshme, pajisje për mjelje.Këto pajisje bëjnë të mundur që kafshët e fermës të kenë zhvillim dhe sjellje karakteristike të specieve.
3. Kërkesat e hollësishme teknike për pajisjet për mbarështimin e kafshëve dhe për inspektimin e tyre përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 18

Jashtëqitjet shtazore

1. Jashtëqitjet shtazore përfshijnë jashtëqitjet e kafshëve, urinën, plehrat e lëngshme dhe përzierjet e lëngshme.
2. Jashtëqitjet dhe kompostot shtazore nuk konsiderohen si mbetje në rastin kur përdoren për plehërimin e tokës bujqësore, për të siguruar rezerva ushqyese për bimët dhe ruajtjen e pjellorisë së tokës, sipas rregullave dhe praktikës bujqësore dhe mbarështimit të kafshëve.
3. Jashtëqitjet shtazore, që nuk përdoren për plehërim, siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni, trajtohen sipas rregullave për menaxhimin e mbetjeve, të parashikuara në ligjin nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”.

Neni 19

Vendgrumbullimet e jashtëqitjeve të kafshëve të fermës

1. Jashtëqitjet e kafshëve trajtohen në mënyrë të tillë që të mos rrezikohet shëndeti i njerëzve dhe i kafshëve, mjedisi, cilësia e ushqimit dhe e produkteve blegtorale.
2. Vendgrumbullimet për jashtëqitjet e kafshëve, grumbujt e jashtëqitjeve, kompostot e ngurta e të lëngshme organike, pellgjet e urinës, depozitat e sedimenteve dhe pajisjet për përpunimin dhe trajtimin e jashtëqitjeve të kafshëve duhet të plotësojnë kërkesat e përshkruara teknike dhe teknologjike.
3. Kërkesat e hollësishme teknike dhe teknologjike për vendgrumbullimet dhe pajisjet, sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe administrimi i jashtëqitjeve të kafshëve përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 20

Administrimi i burimeve të mjaltit

1. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në bazë të propozimeve të shoqatave të bletërritësve, miraton për një periudhë pesëvjeçare programin e shfrytëzimit të kullotave. Në program përcaktohen edhe rregullat për transportin e zgjojeve të bletëve, koha e shfrytëzimit të burimit, largësia e parqeve dhe ndërrimi i kullotës.
Në rastet kur në një zonë të vetme bletërritësish janë disa shoqata të tilla, ato paraqesin një propozim të përbashkët të administrimit të kullotave mjaltëdhënëse për zonën përkatëse.
Në rastet kur në një territor të caktuar nuk ka shoqata bletërritësish, ose nëse një shoqatë e tillë nuk arrin të dalë me një propozim për administrimin e kullotës mjaltëdhënëse, propozimi bëhet nga Shoqata Kombëtare e Bletërritësve.
2. Shoqata Kombëtare e Bletërritësve përgatit një program monitorimi dhe parashikimi të sekrecioneve të nektarit dhe pjalmi, i cili miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për një periudhë prej 5 vjetësh. Programi zbatohet si shërbim publik në blegtori. Në program përfshihen edhe të dhëna për territorin, mënyra e mbledhjes së të dhënave, kushtet dhe mënyra e njoftimit të përdoruesve.
3. Autoriteti kompetent në ministri mban regjistrin për shfrytëzimin e kullotave mjaltëdhënëse. Regjistri i këtyre kullotave përmban bazën e të dhënave, ku jepet informacion për identifikimin, kapacitetin dhe llojet e kullotave, si dhe bëhet parashikimi i sekretimit të nektarit dhe pjalmi në rritjen e bletëve.
4. Kushtet e hollësishme për mbajtjen e regjistrit të kullotave mjaltëdhënëse, për menaxhimin e tyre, për lëvizjen e parqeve të bletëve në kullota dhe programi i parashikimit të sekrecionit të nektarit dhe pjalmi përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 21

Identifikimi i kafshëve të fermës për qëllime zooteknike

1. Kafshët e fermës, për qëllime zooteknike, identifikohen dhe regjistrohen sipas mënyrës së përcaktuar në programin racor.
2. Lista e specieve të kafshëve të fermës, që identifikohen për qëllime zooteknike, metoda e identifikimit, tipi, përmbajtja dhe forma e mbajtjes së regjistrit të fermës, si dhe të dhënat e tjera përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 22

Baza e të dhënave në blegtori

1. Mbarështuesit e kafshëve, zbatuesit e shërbimeve publike dhe organizatat e mbarështimit të kafshëve mbajnë regjistra dhe të dhëna të tjera të përcaktuara, të lidhura me sistemin kombëtar e ndërkombëtar të informacionit në fushën e mbarështimit të kafshëve.
2. Ministria organizon sistemin kombëtar të grumbullimit dhe të përdorimit të të dhënave për tiparet e prodhimit të kafshëve dhe siguron lidhjen e mundësinë e hyrjes në baza të tjera të të dhënave të bujqësisë që lidhen me të dhënat e blegtorisë. Autoriteti kompetent në ministri përcakton mënyrën e mbajtjes dhe të grumbullimit të të dhënave për riprodhimin, matjen e prodhimit, si dhe për tipare të tjera, të përcaktuara në mbarështimin e kafshëve të fermës.
3. Shpenzimet për mbajtjen e të dhënave, të përcaktuara në këtë ligj, nga zbatuesit e shërbimeve publike financohen nga Buxheti i Shtetit.
4. E drejta e përdorimit të të dhënave u njihet edhe zbatuesve të shërbimit zooteknik, publik, në fushën e këshillimit bujqësor, që realizohet nëpërmjet një kontrate dypalëshe.
5. Mënyra e komunikimit të të dhënave nga fusha e mbarështimit të kafshëve, metoda e marrjes së të dhënave, përdorimi i tyre, si dhe rregullat e hollësishme për mirëmbajtjen e regjistrave dhe të dhënave të tjera përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe mbështeten në procedurat dhe metodat e përcaktuara nga organizatat ndërkombëtare kompetente në mbarështimin e kafshëve.

Neni 23

Përdorimi i të dhënave të tjera

1. Përveç të dhënave të përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji, zbatuesit e shërbimit zooteknik, publik kanë të drejtë të marrin dhe të përdorin të dhëna të mbajtura nga autoritete shtetërore, institucione publike dhe agjenci të tjera të autorizuara për:
 - a) kadastrën e tokës, objektet agroblegtorale, mbajtjen e të dhënave statistikore në mbarështimin e kafshëve, në praktikën veterinarë dhe pyjet, të dhënave mjedisore për bujqësinë dhe mbarështimin e kafshëve;
 - b) mbajtjen e të dhënave për ndarjen e njësive territoriale, për tokën, për popullsinë, planet topografike dhe hartat topografike kryesore, të dhënave të tjera për mbarështimin e kafshëve.
2. Mundësia e hyrjes së drejtpërdrejtë në të dhënat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni lejohet në masën që është e domosdoshme për kryerjen e detyrave të shërbimit zooteknik, publik, të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 24

Metodat e mbarështimit të kafshëve

1. Sipas metodave të mbarështimit të kafshëve, fermat agrolegtorale klasifikohen në:
 - a) ferma agrolegtorale me sistem të mbarështimit konvencional;
 - b) ferma agrolegtorale me sistem të mbarështimit të integruar;
 - c) ferma agrolegtorale me sistem të mbarështimit organik.
2. Në bazë të metodës së mbarështimit, fermat agrolegtorale përfshihen në regjistrin e prodhuesve dhe të përpunuesve të prodhimeve legjtorale me emërtimet:
 - a) ferma agrolegtorale të bujqësisë, konvencionale;
 - b) ferma agrolegtorale të bujqësisë, të integruara;
 - c) ferma agrolegtorale të bujqësisë, organike.
3. Regjistri i fermave agrolegtorale të bujqësisë organike mbahet nga organizatat e përcaktuara në ligjin nr. 9199, datë 26.2.2004 “Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve BIO”.
4. Kriteret e klasifikimit dhe të regjistrimit të fermave agrolegtorale, sipas metodës së mbarështimit konvencional ose të integruar, përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 25

Cilësia e produkteve me origjinë nga kafshët

1. Zbatimi i metodave të mbarështimit të kafshëve, transporti, therja e kafshëve të fermës dhe përpunimi i produkteve në kushte familjare të paracaktuara për konsum njerëzor duhet të sigurojnë prodhimin me cilësinë më të mirë të mundshme dhe të sigurt nga ana ekologjike.
2. Në etiketën e produkteve legjtorale të prodhuara në mënyrë familjare shënohet metoda e mbarështimit të kafshëve të fermës, e përcaktuar sipas nenit 24 të këtij ligji.

KREU III

PROGRAMET RACORE, MODIFIKIMET DHE RUAJTJA E TIPAREVE TË KAFSHËVE TË FERMËS

Neni 26

Programet e përmirësimit racor

1. Në programin racor përcaktohen objektivat e mbarështimit, madhësia e popullatës, metodat e rritjes, të riprodhimit, përzgjedhjes, zhvillimit dhe synimet e kërkimit, masat për një mbarështim efektiv të kafshëve të fermës, shtrirja e përmirësimit gjenetik, përmirësimi i cilësisë së produkteve legjtorale, kushtet për bashkërendimin dhe përdorimin e shërbimeve të programeve racore, sipas standardeve zooteknike.
2. Në standardet zooteknike, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshihen procedurat dhe metodat e mbajtjes së regjistrave dhe të librave të racës, përmbajtja e dokumenteve zooteknike, kërkesat për pranimin e kafshëve për qëllime racore, metodat për monitorimin e tipareve dhe vlerësimin e vlerave gjenetike, kushtet për tregtimin e materialeve racore, specifikimi i përdorimit të riprodhuesve të veçantë, përcaktimi i metodave të publikimit të të dhënave. Standardet zooteknike për çdo kafshë të fermës përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
3. Programet racore hartohen nga institucionet e specializuara e nga organizatat e mbarështuesve të kafshëve dhe miratohen nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në bazë të mendimit të dhënë nga Këshilli i Legjtorisë.

4. Programet racore zbatohen nga institucionet e specializuara dhe organizatat e mbarështimit të kafshëve. Çdo lloj ose racë e kafshëve të fermës mund të jetë objekt i një ose disa programeve të përmirësimit racor.
5. Në rast se aplikuesi nuk dëshiron që programi i tij të përfshihet në programin bazë racor, ky fakt deklarohet në aplikim.
6. Kohëzgjatja e zbatimit të një programi racor është jo më pak se 5 vjet.
7. Programi i miratuar racor shfuqizohet para mbylljes, në rastet kur:
 - a) janë evidentuar pengesa ose mungesa materiale në zbatimin e programit të miratuar të mbarështimit;
 - b) ka përfunduar afati i vlefshmërisë së njohjes së organizatës së mbarështuesve.
8. Vlerësimi i ecurisë së programeve racore bëhet çdo vit nga autoriteti kompetent në ministri.

Neni 27

Metodat e përmirësimit racor

1. Metoda e përmirësimit racor është pjesë e detyrueshme e programeve racore, ku përcaktohen metoda e testimit, metoda e vlerësimit, metoda e përzgjedhjes së kafshëve të fermës, si dhe metodat e përdorimit të riprodhuesve.
2. Pas miratimit të programit racor, modifikimi ose përdorimi i metodave të reja, për parashikimin e vlerave racore dhe vlerësimin e riprodhuesve, vendoset nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në bazë të mendimit të dhënë nga Këshilli i Blegtorisë.

Neni 28

Kërkesat për miratimin e programeve racore

Programi i përmirësimit racor, përveç kushteve të përmendura në nenet 26 e 27 të këtij ligji, miratohet kur:

- a) mundëson përmirësimin e mbarështimit të kafshëve;
- b) arrin objektivat e vendosur për nivelin e prodhimit, aftësinë për punë, si dhe tipare të tjera të kafshëve të fermës;
- c) siguron një numër të mjaftueshëm të kafshëve të fermës;
- ç) siguron ekspertizën e nevojshme dhe programin teknik e organizativ për realizimin e tij;
- d) siguron staf teknik të kualifikuar dhe të përshtatshëm;
- dh) identifikon riprodhuesit e përfshirë në program në një mënyrë të caktuar;
- e) siguron mirëmbajtjen e të gjithë dokumentacionit të përshkruar;
- ë) siguron ruajtjen e ndryshueshmërisë gjenetike dhe biodiversitetin në blegtori;
- f) siguron se zbatimi i këtij programi parandalon bashkëgjakësinë dhe garanton rezervat gjenetike;
- g) siguron sistemin e brendshëm të kontrollit për veprimtaritë kyçe në zbatimin e programit racor dhe të metodave të mbarështimit.

Neni 29

Dokumentacioni zooteknik

1. Dokumentacioni zooteknik për një program racor të miratuar mbahet nga një organizatë e mbarështimit të kafshëve ose institucion i specializuar për fushën dhe territorin e zbatimit të programit racor të miratuar.

2. Përmbajtja, forma dhe kushtet e hollësishme për dokumentet zooteknike përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 30

Programi bazë racor

1. Republika e Shqipërisë, për mbrojtjen e burimeve gjenetiko-shtazore, për sigurimin e ndryshueshmërisë dhe përmirësimin gjenetik të blegtorisë, si dhe për ruajtjen e numrit të kërkuar të kafshëve në mbarështim dhe materialeve të tjera racore, ka një program bazë racor (më poshtë PBR), që zbatohet si shërbim publik në blegtori.
2. Zbatimi i PBR-së mbështetet me fonde financiare nga Buxheti i Shtetit.
3. Ministri, në bazë të propozimit të Këshillit të Blegtorisë, përcakton programet e miratuara racore, që përfshihen në PBR.
4. Nëse nuk ka një program të miratuar për një racë të veçantë të kafshëve të fermës me interesa kombëtarë, për të hyrë në PBR, programi përkatës i ruajtjes dhe/ose i përmirësimit përgatitet nga ministria, e cila do të sigurojë edhe zbatimin e tij.
5. Ministria siguron zbatimin e përhershëm të PBR-së. Në program specifikohen mënyra e financimit, e zbatimit, si dhe periudha e vlefshmërisë së saj.
6. Zbatuesit e PBR-së raportojnë në ministri për zbatimin e saj një herë në vit. Për informimin, promovimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, zbatuesit e PBR-së publikojnë programet e miratuara racore dhe rezultatet e zbatimit të tyre.

Neni 31

Masa të veçanta

Kur qëllimet dhe objektivat e programit racor rrezikohen për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme, që nuk mund të parashikohen, ministria përshtat dhe/ose propozon masa të veçanta për realizimin e objektivave dhe të qëllimeve të këtij ligji.

Neni 32

Libri gjenealogjik

1. Libri gjenealogjik mbahet nga një organizatë mbarështuesish të kafshëve të racës ose nga një institucion i specializuar për çdo lloj race. Në këtë libër regjistrohet çdo kafshë race që plotëson kërkesat e përcaktuara.
2. Kërkesat e hollësishme për regjistrimin e kafshëve dhe mbajtjen e librit gjenealogjik përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 33

Kafshë riprodhuese me vlera racore

1. Kafshë riprodhuese me vlera racore janë vetëm ato kafshë të fermës, që në kohën e maturimit seksual janë të afta dhe të destinuara për riprodhim dhe që plotësojnë kërkesat e përshkruara në programet racore të miratuara.
2. Riprodhuesit me vlera racore duhet të kenë prejardhje të njohur, të përfshihen në librin gjenealogjik dhe dokumentacioni i rekomanduar të mbahet sipas kërkesave të këtij ligji.

Riprodhuesit duhet të plotësojnë kërkesat e përzgjedhjes për qëllime të përmirësimit racor në faza të veçanta, sipas programeve racore.

3. Kërkesat për përdorimin e kafshëve me vlera racore, për qëllime riprodhimi, përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 34

Kafshë të tjera për riprodhim

1. Kur është e domosdoshme që raca dhe linja të ruhen nga rreziku i zhdukjes ose për arsye të tjera, si kafshë riprodhuese me vlerë racore përcaktohen edhe kafshë të tjera të fermës, që nuk plotësojnë kërkesat e pikave 1 e 2 të nenit 33 të këtij ligji.

2. Ministria, në bazë të kërkesës së paraqitur nga një mbarështues ose nga një organizatë e miratuar mbarështuesish, miraton përdorimin për riprodhim të kafshëve që marrin pjesë në një program racor, nëse nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara sipas nenit 33 të këtij ligji.

Neni 35

Gjenealogjia e kafshëve riprodhuese

1. Gjenealogjia e kafshëve riprodhuese ose e materialit tjetër riprodhues duhet të ketë prejardhje të njohur. Gjenealogjia mund të jetë e plotë ose e pjesshme. Kafsha vlerësohet se ka gjenealogji të plotë nëse i njihen dy ose më shumë gjenerata të paraardhësve, të përshkruara në programin racor.

2. Kafsha vlerësohet se ka gjenealogji të pjesshme nëse paraardhësit e saj nuk njihen plotësisht.

Në një rast të tillë, në programin racor përcaktohet pjesa minimale e njohur e prejardhjes.

3. Kërkesat e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij neni nuk zbatohen për bletët dhe krimbin e mëndafshit.

4. Kërkesat e hollësishme për prejardhjen e plotë ose të pjesshme, si dhe metodat e mënyrat e kontrollit përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 36

Klasifikimi i kafshëve për riprodhim

1. Për përfshirjen e kafshëve në librin gjenealogjik, për krahasimin e materialeve racore në treg dhe zbatimin e programeve racore, si dhe për qëllime të tjera mbarështimi, çdo riprodhues vlerësohet dhe klasifikohet me klasën përkatëse të cilësisë.

2. Procedurat dhe metodat e klasifikimit në klasat e cilësisë përcaktohen nga programi racor.

Neni 37

Njohja e racave dhe e linjave të reja

1. Zhvillimi i racave dhe i linjave të reja të kafshëve të fermës në territorin e Republikës së Shqipërisë miratohet nga ministri, në përputhje me kërkesën e shoqatës së rritësve dhe mendimin e Këshillit të Blegtorisë.

2. Kur në programet racore të miratuara përfshihen raca dhe linja të reja, si dhe kafshë riprodhuese të importuara, ato do t'u nënshtrohen kontrolleve krahasuese të tipareve të veçanta, në përputhje me programin racor.

Neni 38

Kërkesat për riprodhuesit meshkuj

1. Qendrat e prodhimit të spermës lejohen të përdorin riprodhues meshkuj të vlerësuar nga pasardhësit, të përzgjedhur sipas vlerësimit të bërë në bazë të dokumenteve zooteknike. Stacionet e ndërzimit natyror lejohen të përdorin riprodhues meshkuj, të përzgjedhur sipas metodave zooteknike.
2. Programi racor i miratuar përcakton kërkesat dhe metodat e përdorura, si dhe periudhën e njohjes për shfrytëzimin e riprodhuesve meshkuj.
3. Programi racor i miratuar siguron një numër të mjaftueshëm riprodhuesish meshkuj ose doza sperme, në përshtatje me programet vjetore për përdorimin individual të riprodhuesve meshkuj.
4. Në raste të veçanta, kur riprodhimi i kafshëve të fermës rrezikohet, ministri mund të lejojë ndryshimin e kushteve të pikës 1 të këtij neni.

Neni 39

Sperma

1. Sperma përdoret kur plotëson kërkesat e mëposhtme:
 - a) është vjelë dhe ruajtur në qendrat e miratuara të prodhimit të spermës;
 - b) është vjelë nga riprodhues meshkuj, të vlerësuar nga pasardhësit dhe që plotësojnë kërkesat e nenit 38 të këtij ligji;
 - c) tregtohet në mënyrë të veçantë dhe shoqërohet me dokumentet përkatëse;
 - ç) plotëson kërkesat për cilësi në dhe shëndetin e kafshëve dhe i është nënshtruar vlerësimit nga një laborator i certifikuar.
2. Për specie të veçanta të kafshëve të fermës lejohet përdorimi i spermës së përzier.
3. Kushtet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për lepujt, shpendët, bletët dhe krimbin e mëndafshit.
4. Kërkesat e hollësishme për prodhimin, tregtimin dhe kontrollin e spermës përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 40

Vezët dhe embrionet

1. Përdorimi i vezëve dhe i embrioneve të kafshëve lejohet kur:
 - a) janë mbledhur, ruajtur dhe tregtuar në mënyrë të veçantë nga një organizëm i miratuar për mbledhjen, ruajtjen, tregtimin dhe transferimin e embrioneve;
 - b) janë me origjinë nga kafshë race, që përmbushin kërkesat për mbledhjen e vezëve dhe të embrioneve;
 - c) janë të shoqëruara me dokumentet zooteknike;
 - ç) plotësojnë kërkesat e cilësisë dhe të ruajtjes së shëndetit të kafshëve dhe i janë nënshtruar vlerësimit nga një laborator i certifikuar.
2. Kërkesat e këtij neni nuk zbatohen për vezët e pulave, që shërbejnë për çelje, për bletët dhe krimbin e mëndafshit.
3. Kërkesat e hollësishme për përdorimin e vezëve dhe të embrioneve përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 41

Kërkimi shkencor në kafshët e fermës

Përdorimi i metodave të inxhinierisë gjenetike në kafshët e fermës lejohet vetëm për qëllime kërkimore-shkencore.

Neni 42

Provat biologjike dhe gjenetike

1. Provat biologjike dhe gjenetike kryhen për të siguruar të dhënat e nevojshme për punën përzgjedhëse, ruajtjen e racave autoktone dhe programet për ruajtjen e ndryshueshmërisë biologjike të kafshëve të fermës.
 2. Provat gjenetike kryhen në laboratorë të akredituar.
- Provat biologjike dhe gjenetike duhet të sigurojnë krahasueshmërinë e metodave dhe të rezultateve të arritura në nivel ndërkombëtar.

Neni 43

Stacionet e provës

1. Një stacion prove i miratuar ose organizatë tjetër e mbarështimit të kafshëve kryen përpunimin e të dhënave nga matjet, provat, llogaritjet dhe publikimet e rezultateve.
2. Procedurat dhe metodat e provës së specieve të veçanta të kafshëve të fermës dhe provat krahasuese bëhen në përputhje me programet racore dhe janë të krahasueshme në nivel ndërkombëtar.
3. Propozimet për ngritjen e një stacioni prove bëhen nga një organizëm ose organizatë e mbarështuesve të kafshëve, në kuadër të një programi racor.
4. Ministri miraton ngritjen e një stacioni prove për një periudhë 5-vjeçare.
5. Ministria mban regjistrin e stacioneve të provës dhe kryen vëzhgimin e veprimtarisë së tyre.
6. Kushtet për miratimin e ngritjes së stacioneve të provës, procedurat dhe metodat e provës, si dhe procedurat e regjistrimit përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

KREU IV

PËRHAPJA E PËRMIRËSIMIT GJENETIK NË POPULLATAT E KAFSHËVE TË FERMËS

Neni 44

Përhapja e përmirësimit gjenetik

1. Ministria, nëpërmjet institucioneve dhe organizatave të mbarështimit të racës, të miratuara, ndjek dhe vlerëson përhapjen e përmirësimit gjenetik në popullatat e kafshëve të fermës.
2. Përhapja e përmirësimit gjenetik realizohet nëpërmjet financimit ose bashkëfinancimit të prodhimit të riprodhuesve meshkuj me vlerë të lartë racore, nga programet e përmirësimit gjenetik të popullatës dhe nga veprimtari të tjera, që mbështesin ruajtjen dhe rritjen e cilësive gjenetike të kafshëve të fermës.

Neni 45

Parashikimi i vlerës gjenetike

1. Metodat dhe procedurat për parashikimin e vlerës gjenetike duhet të jenë shkencërisht të pranueshme dhe të krahasueshme me procedurat dhe metodat e vendosura nga organizatat ndërkombëtare kompetente.
2. Parashikimi i vlerës gjenetike bëhet për një nivel të caktuar të klasës së kafshëve, të përfshira në një program racor.

Neni 46

Vlerësimi dhe përzgjedhja e kafshëve të racës

1. Kafshët e racës vlerësohen dhe përzgjidhen për ndërzim, në përputhje me programin racor.
2. Kriteret e hollësishme për përzgjedhjen dhe vlerësimin e kafshëve të racës përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 47

Provat e tipareve të prodhimit dhe parashikimi i vlerave gjenetike

1. Provat e tipareve të prodhimit dhe parashikimi i vlerave gjenetike të kafshëve të racës kryhen nga stacionet e provës, nën drejtimin e institucioneve të specializuara, sipas këtij ligji.
2. Provat e tipareve të prodhimit dhe parashikimit të vlerave gjenetike, të kryera në shtete të tjera, për raca të caktuara, njihen edhe në Republikën e Shqipërisë, në rast se rezultatet e këtyre provave dhe parashikimet janë dyanshmërisht të krahasueshme dhe të pranueshme nga institucioni i specializuar.

Neni 48

Riprodhimi i kafshëve të fermës

1. Riprodhimi i kafshëve të fermës përbën veprimtari zooteknike që kryhet nëpërmjet inseminimit ose ndërzimit natyror.
2. Personi që kryen inseminimin artificial ose drejton ndërzimin natyror të kafshëve të fermës mban shënimet dhe dokumentacionin e përshkruar, në përputhje me programin racor.
3. Kushtet e hollësishme për veprimtarinë e riprodhimit të kafshëve të fermës përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 49

Bashkëgjakësia

1. Programi racor siguron riprodhimin nëpërmjet pranimi të koeficientit të lejueshëm të afërsisë së gjakut, për të parandaluar efektet negative të bashkëgjakësisë në gjallëri, rritje, aftësi për të mbijetuar, pjellori dhe tipare të tjera të kafshëve të fermës në gjeneratat pasardhëse.

2. Afërsia e gjakut lejohet për qëllime shkencore. Në këtë rast institucioni kërkimor-shkencor aplikon në ministri për marrjen e lejes, duke përshkruar me hollësi kërkimin shkencor dhe qëllimet e tij.
3. Në raste të veçanta, ministri mund të lejojë bashkëgjakësinë. Raste të veçanta mund të përbëjnë raca të veçanta të rrezikuara për zhdukje, shpërthime sëmundjesh dhe raste të tjera të ngjashme.

Neni 50

Inseminimi artificial

Inseminimi artificial kryhet nga persona fizikë ose juridikë, të cilët përmbushin këto kërkesa:

- a) të jenë të kualifikuar;
- b) të ushtrojnë veprimtarinë në mjedise të përshtatshme dhe kanë pajisjet e nevojshme të përcaktuara në programin racor;
- c) të sigurojnë inseminimin e kafshëve të fermës në mënyrë të pandërprerë për jo më pak se një vit;
- ç) të kenë nënshkruar kontratë me një ose disa qendra prodhimi dhe/ose qendra shpërndarjeje të spermës, të miratuara;
- d) të përdorin spermë që përmbush kërkesat e nenit 39 të këtij ligji dhe të zbatojnë inseminimin, në përputhje me metodat e çiftëzimit dhe programin racor, si dhe të plotësojnë, të mbajnë dhe të shpërndajnë dokumentacionin e përshkruar;
- dh) të kenë mundësi të informojnë fermerin për treguesit e arritur të riprodhimit.

Neni 51

Inseminatorët

1. Inseminatorët janë persona fizikë ose juridikë, që kryejnë veprimtari në fushën e riprodhimit të kafshëve të fermës.
2. Personat fizikë ose juridikë, që kryejnë inseminimin dhe përmbushin kërkesat e nenit 50 të këtij ligji, regjistrohen në librin e inseminatorëve. Libri i inseminatorëve për personat fizikë, që kryejnë inseminimin, hapet dhe mbahet nga inspektori zooteknik në DBU-në e qarkut.
3. Inseminatori u jep qendrës së prodhimit ose shpërndarjes së spermës dhe inspektorit zooteknik në DBU-në e qarkut, në mënyrë periodike, të dhënat e kërkuara për spermën e përdorur, të ndarë për çdo inseminim.
4. Në rastet e vërtetimit të parregullsive në zbatimin e inseminimit, Inspektorati i Zooteknisë lë detyra dhe përcakton afate për ndreqjen e parregullsive jo më vonë se 15 ditë nga vënia re e tyre.
5. Inseminatorët nuk mund të autorizojnë persona të tjerë për kryerjen e inseminimit.
6. Inseminatorët pajisen me certifikatë të aftësisë profesionale për inseminim, e cila lëshohet nga një institucion i specializuar, i miratuar nga ministri.

Neni 52

Përjashtime

Kushtet sipas neneve 50 dhe 51 të këtij ligji nuk zbatohen për shpendët, lepujt, bletët dhe krimbin e mëndafshit.

Neni 53

Stacioni i ndërzimit natyror

1. Stacioni i ndërzimit natyror e ushtron veprimtarinë nëse plotëson kërkesat e miratuara për personelin teknik, pajisjet, mjetet dhe riprodhuesit meshkuj. Miratimi i lejes për ushtrimin e veprimtarisë së ndërzimit natyror bëhet në bazë të kërkesave të paraqitura tek inspektori i zooteknisë në DBU-në e qarkut.
2. Kërkesat për ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të ndërzimit natyror përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 54

Qendrat e prodhimit të spermës dhe qendrat riprodhuese

1. Qendrat e miratuara të prodhimit të spermës e ushtrojnë veprimtarinë nëse përmbushin kushtet e përcaktuara për mjedisin, stafin, pajisjet dhe mbajnë një numër të caktuar të riprodhuesve meshkuj për mbledhjen dhe tregtimin e spermës, duke respektuar rregullat e praktikës veterinare.
2. Qendrat e miratuara të prodhimit të spermës, në zbatim të programit racor, kanë këto përgjegjësi:
 - a) hartimin e skemave të çiftëzimit dhe të programit të inseminimit;
 - b) vlerësimin e cilësisë së spermës së prodhuar;
 - c) parandalimin e bashkëgjakësisë;
 - ç) ruajtjen e ndryshueshmërisë biologjike dhe gjenetike në blegtori;
 - d) përdorimin e efekteve të heterozisit;
 - dh) mbajtjen e dokumentacionit të përshkruar në këtë ligj për riprodhuesit meshkuj, mbledhjen e spermës dhe mbajtjen e shënimeve për tregtimin e spermës së prodhuar prej tyre;
 - e) njoftimin çdo vit të ministrisë, sipas mënyrës së kërkuar prej saj.
3. Qendrat riprodhuese të shpendëve, derrave, dhenve e dhive, lepujve, krimbit të mëndafshit dhe mbretërëshave të bletëve organizohen në përputhje me programet racore të miratuara.
4. Riprodhimi i mbretërëshave, tregtimi, lëvizja e koshereve dhe e materialit racor të bletëve bëhen në kushte të veçanta, në zona të mbrojtura rreth qendrës riprodhuese të miratuar.
5. Madhësia e zonës së mbrojtur dhe kushtet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 55

Mbledhja dhe transferimi i embrioneve

1. Mbledhja dhe transferimi i embrioneve bëhet nga një institucion ose organizatë e specializuar për mbledhjen, përgatitjen, ruajtjen, transferimin dhe tregtimin e embrioneve.
2. Kushtet e hollësishme për regjistrimin dhe miratimin e institucionit dhe të organizatës së specializuar përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 56

Qendrat e prodhimit të kafshëve të racës

1. Prodhimi dhe përhapja e kafshëve të racës bëhet nga qendra prodhimi të miratuara, që mund të jenë ferma agroblegtorale, stacione kërkimi dhe qendra industriale blegtorale.
2. Qendrat e prodhimit të kafshëve të racës ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të një programi racor të miratuar.

3. Qendrat e prodhimit të kafshëve të racës, nëpërmjet programit racor të miratuar, finacohen nga Buxheti i Shtetit për prodhimin dhe përhapjen e kafshëve me vlera të larta racore në fermat agroblegtorale dhe në qendrat industriale të prodhimit blegtoral.
4. Nuk përfitojnë financim, sipas pikës 3 të këtij neni, fermat agroblegtorale, stacionet kërkimore, qendrat industriale të prodhimit blegtoral dhe subjektet që tregtojnë kafshë race të importuara.
5. Tregtimi i kafshëve të racës, të prodhuara nga qendrat e prodhimit të kafshëve të racës të miratuara, shoqërohet me një certifikatë racore prodhimi, të miratuar nga inspektori i zooteknisë së DBU-së së qarkut.
6. Modeli i certifikatës racore, që shoqëron kafshët e racës, të prodhuara në qendrat e prodhimit të kafshëve të racës të miratuara, përcaktohet me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
7. Masa dhe mënyra e financimit të qendrave të prodhimit të kafshëve të racës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 57

Procedurat e miratimit të qendrave të prodhimit të materialit racor

1. Leja për zhvillimin e veprimtarisë së qendrave të prodhimit të materialit racor jepet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për një periudhë 5-vjeçare. Në vendimin për dhënien e lejes përcaktohen fusha dhe territori ku do të ushtrohet veprimtaria.
2. Në ministri hapen regjistrat përkatës për qendrat e miratuara të prodhimit të spermës, vezëve për çelje, ovulave dhe embrioneve, mbretërëshave të bletëve, si dhe për fermat agroblegtorale, stacionet e kërkimit dhe qendrat industriale të specializuara për prodhimin e shpërndarjen e kafshëve të racës.
3. Kërkesat e hollësishme për veprimtarinë dhe funksionimin e qendrave të prodhimit të materialit racor përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

KREU V

RUAJTJA E NDRYSHUESHMËRISË GJENETIKE DHE REZERVAT GJENETIKE TË KAFSHËVE TË FERMËS

Neni 58

Ruajtja e ndryshueshmërisë gjenetike

1. Republika e Shqipërisë mban dhe siguron rezerva gjenetike për speciet e veçanta, racat dhe linjat e kafshëve të fermës, në një numër minimal kafshësh, të dozave të spermës, vezëve dhe embrioneve.
2. Për qëllime të ruajtjes së racave dhe/ose të linjave dhe për të siguruar prodhim të mjaftueshëm nga kafshët, programi racor siguron ndryshueshmërinë gjenetike të kafshëve të fermës.
3. Fondet për ruajtjen dhe mbajtjen e rezervave gjenetike sigurohen nga Buxheti i Shtetit.
4. Mënyrat dhe procedurat e ruajtjes dhe të mbajtjes së rezervave gjenetike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 59

Diversiteti biologjik në mbarështimin e kafshëve të fermës

1. Mbrojtja e diversitetit biologjik në mbarështimin e kafshëve të fermës zbatohet si shërbim publik në cilësinë e një banke gjenetike, në përputhje me PBR-në.
2. Programi i mbrojtjes së diversitetit biologjik të kafshëve të fermës përmban:
 - a) ruajtjen e të gjitha racave të kafshëve të fermës të mbarështuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, duke mbrojtur në mënyrë të veçantë racat autoktone në mjedisin autokton;
 - b) ngritjen dhe funksionimin e bankës gjenetike në mbarështimin e kafshëve;
 - c) edukimin dhe trajnimin në fushën e ruajtjes së diversitetit në mbarështimin e kafshëve;
 - ç) ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e ruajtjes së diversitetit biologjik;
 - d) lidhjet me programet e tjera në fushën e bujqësisë;
 - dh) kohëzgjatjen e programit;
 - e) burimet financiare të programit.
3. Shërbimi publik i ngarkuar për ngritjen dhe funksionimin e bankës së gjeneve të kafshëve të fermës monitoron diversitetin në blegtori nëpërmjet vëzhgimeve dhe analizave sistematike të gjendjes së diversitetit biologjik.

Neni 60

Racat autoktone

1. Racat autoktone të kafshëve të fermës vihen në mbrojtje të veçantë të shtetit, i cili nxit dhe mbështet prodhimin e produkteve blegtorale karakteristike me origjinë nga këto raca.
2. Racat autoktone të kafshëve të fermës janë gjedhi autokton, bualli autokton, njëthundrakët, delja e vendit dhe ekotipet e saj, dhia e vendit dhe ekotipet e saj, derrat e vendit, pulat, rosat, patat e vendit, gjelat e detit dhe blea e vendit.
3. Raca autoktone, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, gjykohen edhe ato raca të kafshëve të fermës, të cilat njihen nga ministri si raca autoktone, sipas një vendimi të lëshuar, në bazë të kërkesës së një organizate ose institucioni të miratuar. Kërkesa shoqërohet me një përshkrim teknik, të përgatitur nga një punonjës i shërbimit zooteknik, i ngarkuar për bankën e gjeneve. Këshilli i Blegtorisë jep mendim për kërkesën e paraqitur.
4. Republika e Shqipërisë mbron emrin dhe racat autoktone në nivel ndërkombëtar, në përputhje me marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare ku është palë. Racat autoktone futen në regjistrin e këtyre racave që mbahet në ministri.
5. Masat mbrojtëse për racat autoktone në zhdukje ose në rrezik zhdukjeje përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Kërkesat e hollësishme për mbajtjen e regjistrit të racave autoktone përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

KREU VI

TREGTIMI DHE MARKETIMI I MATERIALEVE RACORE

Neni 61

Tregtimi i kafshëve të racës

1. Kafshët e fermës, të cilat tregtohen si kafshë race ose kafshë që paraqiten në ekspozita, panaiere, vlerësime, ankande dhe konkurrime, identifikohe në mënyrë të veçantë nëpërmjet dokumentacionit shoqërues të veçantë zooteknik.

2. Njëpërmjet kontrollit të Inspektoratit Zooteknik, Republika e Shqipërisë siguron plotësimin e kushteve për tregtimin e materialeve racore. Kontrolli zooteknik ushtrohet në përputhje me marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë.

Neni 62

Tregtimi i spermës

1. Tregtimi i spermës tek inseminatorët bëhet nga qendrat e miratuara të prodhimit të spermës dhe njësitë e tregimit të spermës.
2. Lejohet tregtimi i spermës ndërmjet qendrave të ndryshme të miratuara të prodhimit për specie të caktuara.
3. Qendrat e miratuara të prodhimit nuk kufizojnë tregtimin e spermës së mbledhur nga një qendër tjetër prodhimi ose njësi tregtimi, në rast se sperma plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 63

Tregtimi i embrioneve

1. Tregtimi i embrioneve bëhet nga një institucion ose organizatë e specializuar për mbledhjen, përgatitjen, ruajtjen, transferimin dhe tregtimin e embrioneve, nëse përmbush kërkesat e përshkruara në këtë ligj dhe në ligjin nr.9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”.
2. Kushtet e hollësishme për regjistrimin dhe miratimin e institucionit ose të organizatës së specializuar për këtë qëllim përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrotjtjes së Konsumatorit.

Neni 64

Importet dhe eksportet

1. Republika e Shqipërisë nuk ndalon, kufizon apo parandalon importet dhe eksportet e materialeve racore për qëllime zooteknike.
2. Lejohet importi ose eksporti i kafshëve të racës kur:
 - a) janë të regjistruara në një libër gjenealogjik ose në një regjistër të kafshëve hibride, i mbajtur nga një organizatë rritësisë, të miratuar nga vendi eksportues;
 - b) janë të identifikuara në mënyrë të qartë;
 - c) janë të shoqëruara me dokumentacionin zooteknik dhe veterinar.
3. Lejohet importi ose eksporti i spermës kur:
 - a) vjen nga një riprodhues i regjistruar në një libër gjenealogjik ose në një regjistër të kafshëve racë-hibride, njëpërmjet organizatës, shoqatës apo shoqërisë së miratuar nga vendi eksportues;
 - b) vjen nga një riprodhues i vlerësuar nga pasardhësit dhe ka vlera gjenetike;
 - c) është marrë në qendrën prodhuese, të miratuar nga autoriteti kompetent i shtetit në të cilin ndodhet qendra e prodhimit të spermës, shoqërohet me kartelën gjenealogjike të riprodhuesit dhe sperma etiketohet në mënyrë të qartë.
4. Lejohet importi ose eksporti i embrioneve dhe i vezëve kur:
 - a) vijnë nga kafshë race, të regjistruara në një libër gjenealogjik ose në një regjistër të kafshëve hibride, të mbajtur nga një organizatë e miratuar nga vendi eksportues ose importues;

b) janë të shoqëruara me dokumentacionin zooteknik, të identifikuara në mënyrë të veçantë, janë grumbulluar nga një organizatë e specializuar që ka leje për grumbullimin dhe tregtimin e embrioneve, të lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit eksportues.

5. Dokumentacioni zooteknik shoqëruet i kafshëve të racës, spermës, embrioneve dhe ovulave që importohen, depozitohet në zyrën e inspektoratit zooteknik të qarkut nga personat fizikë dhe juridikë, që importojnë materialet racore.

6. Autoriteti kompetent për lëshimin e lejeve të importit ose eksportit të materialeve racore është Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, e cila ka të drejtën ta delegojë dhënien e këtyre lejeve tek inspektorati i zooteknisë në DBU- në e qarkut.

7. Kërkesa të tjera zooteknike, që kanë lidhje me tiparet e prodhimit, vlerat racore ose tiparet ekonomike për importin e materialeve racore përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

KREU VII

ORGANIZIMI I STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE

I. KOMPETENCAT E MINISTRISË

Neni 65

Autoriteti kompetent

1. Drejtoria e Prodhimit Blegtoral është autoriteti kompetent për zbatimin e këtij ligji dhe për ushtrimin e veprimtarive në fushën e blegtorisë. Drejtoria e Prodhimit Blegtoral përbëhet nga Shërbimi Zooteknik dhe Inspektorati i Zooteknisë. Kjo drejtori siguron zbatimin praktik dhe shkencor të këtij shërbimi nëpërmjet:

- a) Shërbimit Zooteknik dhe Inspektoratit të Zooteknisë në Ministri dhe në qarqe;
- b) Institutit të Kërkimeve Zooteknike, si institucion kërkimor-shkencor në fushën e prodhimit blegtoral;
- c) Shërbimit Këshillimor.

2. Drejtoria e Prodhimit Blegtoral ka këto detyra:

a) harton politikat e zhvillimit dhe programet e mbrojtjes, përmirësimit dhe ruajtjes së cilësive të burimeve gjenetike shtazore, me synim nxitjen e fermerëve për të rritur prodhimet blegtorale, krijimin dhe përhapjen e vlerave racore dhe ruajtjen e ndryshueshmërisë gjenetike të kafshëve të fermës;

b) harton strategjitë afatshkurtra, afatmesme e afatgjata për zhvillimin e blegtorisë;

c) harton aktet ligjore dhe nënligjore për mbarështimin e kafshëve të fermës;

ç) nxit zbatimin e teknologjive bashkëkohore në mbarështimin e kafshëve dhe arritjen e standardeve të cilësisë së produkteve blegtorale;

d) nxit krijimin, fuqizimin dhe formimin profesional të organizatave të mbarështimit të kafshëve të racës;

dh) siguron kontrollin e cilësisë së ushqimeve të kafshëve dhe të ushqyerit e tyre, si dhe siguron monitorimin e prodhimit foragjer;

e) ushtron inspektimin zooteknik në fushën e mbarështimit të kafshëve, të përmirësimit racor, të ushqimeve dhe të të ushqyerit të kafshëve, si dhe të teknologjive të prodhimeve blegtorale;

ë) bashkëpunon me strukturat simotra të Bashkimit Europian, Organizatën Botërore të Ushqimit (FAO), Shoqatën Ndërkombëtare të Prodhimit të Kafshëve (EAAP), Shoqatën Ndërkombëtare të Kontrollit të Prodhimtarisë (ICAR), si dhe me organizata dhe shoqata të tjera;

f) realizon detyrat administrative dhe detyra të tjera sipas këtij ligji.

3. Në raste emergjence, lufte, raste fatkeqësish natyrore kjo drejtori përgatit propozime, të cilat miratohen nga ministri, për organizatat e rritësve dhe/ose të tjera, për të ruajtur materialet racore të rrezikuara, që janë të nevojshme për të siguruar në një shkallë minimale riprodhimin e kafshëve të fermës dhe diversitetin biotik të tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.
4. Detyrat e hollësishme të Drejtorisë së Prodhimit Blegtoral përcaktohen në rregulloren e funksionimit të ministrisë.

II. SHËRBIMI ZOOTEKNIK

Neni 66

Shërbimi zooteknik

1. Drejtoria e Prodhimit Blegtoral në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, sektorët e zooteknisë në DBU-të e qarqeve, Instituti i Kërkimeve Zooteknike dhe shërbimi zooteknik privat janë përgjegjës për zbatimin e këtij ligji.
2. Veprimtaritë zooteknike realizohen nga shërbimi zooteknik publik ose privat, sipas parashikimeve të përcaktuara në këtë ligj.
3. Shërbimet zooteknike publike ose private organizohen në mënyrë të tillë që t'i sigurojnë pronarit ose kujdestarit të kafshëve një rrjet shërbimi zooteknik të përhershëm dhe të hapur.

Neni 67

Fushat e zbatimit të shërbimit zooteknik

1. Shërbimet zooteknike publike ose private ofrojnë dhe zbatojnë shërbime për zbatimin e programit bazë racor, vlerësimin e tipareve prodhuese të kafshëve të fermës, përhapjen e përmirësimit gjenetik, mbrojtjen dhe monitorimin e biodiversitetit, ushqimet dhe të ushqyerit e kafshëve, prodhimin e foragjereve, bazën e të dhënave, ruajtjen dhe mbajtjen e regjistrit të burimeve të mjaltit, organizatat e mbarështuesve të kafshëve të racës dhe trajnimin në blegtori.
2. Shërbimet zooteknike publike ose private njoftojnë mbarështuesit e kafshëve për çdo rezultat të arritur nga prova të kryera të kafshët e racës, brenda fushës, kohës së caktuar dhe mënyrës së kërkuar nga programi racor.

III. INSPEKTIMI DHE KONTROLLI

Neni 68

Inspektorati i Zooteknisë

1. Inspektorati i Zooteknisë siguron kontrollin për plotësimin e kushteve për mbarështimin e qëndrueshëm të kafshëve të fermës, përmirësimin racor, ushqimet dhe të ushqyerit e kafshëve dhe tregtimin e materialeve racore. Drejtori i Drejtorisë së Prodhimit Blegtoral në Ministri është njëkohësisht Kryeinspektor i Inspektoratit të Zooteknisë.
Inspektorët e Zooteknisë në Ministri e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në zbatim të këtij ligji dhe ligjeve të tjera, në bazë të të cilave funksionon ky inspektorat.
2. Inspektori i zooteknisë në DBU- në e qarkut e ushtron veprimtarinë në territorin që mbulon DBU-ja e qarkut.

3. Kryeinspektori i Inspektoratit të Zooteknisë bashkëpunon me DBU-të e qarqeve për përzgjedhjen e inspektorëve të zooteknisë, të cilët i propozohen për miratim Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
4. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit shqyrton propozimet e bëra dhe miraton inspektorët e zooteknisë në DBU-të e qarqeve.

Neni 69

Kompetencat e inspektorit të zooteknisë

1. Inspektori i zooteknisë ushtron kontroll për:
- a) zbatimin e dispozitave të parashikuara në këtë ligj dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
 - b) kushtet, teknologjitë, kujdesin dhe pajisjet e përcaktuara për rritjen e kafshëve në ferma, ndërtimet agroblegtorale, pajisjet dhe lehtësitë për qëllime mbarështimi, si dhe dokumentacionin e veprimtarisë së personave juridikë ose fizikë, që merren me blegtori;
 - c) plotësimin e kushteve të përcaktuara për realizimin e veprimtarive të programit racor dhe prodhimin, përpunimin, tregtimin dhe përdorimin e ushqimeve, në përputhje me ligjin nr. 8411, datë 1.10.1998 “Për ushqimet e blegtorisë”;
 - ç) zbatimin e programit në qendrat e prodhimit të materialit racor;
 - d) zbatimin e shërbimeve publike;
 - dh) identifikimin e kafshëve të fermës për qëllime zooteknike, mbajtjen e regjistrave dhe të dokumenteve të tjera të fermës;
 - e) dokumentacionin e përshkruar zooteknik;
 - ë) kushtet e përcaktuara për vjeljen, ruajtjen, tregtimin dhe përdorimin e spermës, vezëve dhe embrioneve;
 - f) zbatimin e provave të kafshëve të racës;
 - g) zbatimin e procedurës së vlerësimit e të përzgjedhjes së kafshëve të racës dhe miratimin e riprodhuesve;
 - gj) zbatimin e kriterëve për riprodhimin e kafshëve të fermës dhe plotësimin e kushteve të inseminimit;
 - h) përputhshmërinë e etiketimit të produkteve blegtorale me metodat e mbarështimit.
2. Detyrat e hollësishme të inspektorit të zooteknisë përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 70

Masat përmirësuese që vendos inspektori i zooteknisë

Inspektori i zooteknisë, gjatë ushtrimit të kontrollit, urdhëron marrjen e masave përmirësuese si më poshtë:

- a) mbarështimin, sipas kërkesave të përshkruara në këtë ligj;
- b) bllokimin e pajisjeve të papërshtatshme për mbarështimin e kafshëve të fermës;
- c) zbatimin e masave për administrimin e mirë të burimeve të mjaltit;
- ç) shmangien e mangësive dhe të çrregullimeve në zbatimin e programeve racore të miratura;
- d) propozimin e masave shtesë për zbatimin e programeve racore të miratuara;
- dh) shmangien e mangësive dhe të çrregullimeve në mbajtjen e regjistrave të fermës dhe dokumentacionit tjetër;
- e) ndalimin e grumbullimit, të tregtimit dhe përdorimit të spermës, vezëve dhe embrioneve, kur nuk plotësohen kërkesat e përshkruara në këtë ligj;
- ë) shmangien e mangësive dhe të çrregullimeve në provat e kafshëve të racës;
- f) shmangien e mangësive dhe të çrregullimeve në zbatimin e inseminimit;

- g) marrjen e masave për shmangien e praktikave të zhvillimit të pabarabartë të një organizate të miratuar;
- gj) shmangien e mangësive dhe të çrregullimeve në etiketimin e produkteve familjare blegtorale;
- h) shmangien e mangësive dhe të çrregullimeve në zbatimin e detyrave dhe të veprimtarive të tjera, në përputhje me këtë ligj.

Neni 71

Burimet financiare

Shërbimi zooteknik publik financohet nga Buxheti i Shtetit, si dhe nga projekte e burime financiare, të siguruara nga veprimtari zooteknike.

Neni 72

Pagesat për shërbimet publike

1. Përfituesit e shërbimeve publike zooteknike paguajnë tarifa shërbimi të pjesshme ose të plota. Në raste të jashtëzakonshme, të përcaktuara në këtë ligj, shërbime të tilla publike mund të jenë falas.
2. Tarifat e shërbimeve publike përcaktohen me rregullore të ministrit.

IV. KËSHILLI I BLEGTORISË

Neni 73

Përbërja e Këshillit të Blegtorisë

1. Këshilli i Blegtorisë përbëhet nga 11 anëtarë:
Tre përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dy përfaqësues nga Instituti i Kërkimeve Zooteknike, një përfaqësues nga Instituti i Kërkimeve Veterinare, një përfaqësues nga Departamenti i Prodhimit Shtazor në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, një përfaqësues nga inspektoratet e zooteknisë në qarqe, një përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave dhe dy përfaqësues nga organizatat mbarështuese të kafshëve të racës.
2. Anëtarët e Këshillit të Blegtorisë propozohen nga institucionet dhe organizatat e mbarështuesve të kafshëve të racës dhe miratohen nga ministri për një periudhë prej 4 vjetësh, me të drejtë rizgjedhjeje. Ministri thërret në mbledhjen e parë anëtarët e Këshillit, të cilët zgjedhin kryetarin dhe sekretarin nga vetë anëtarët.
3. Këshilli harton rregulloren e brendshme për funksionimin e tij. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit të Blegtorisë caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 74

Detyrat e Këshillit të Blegtorisë

1. Këshilli i Blegtorisë është organ këshillues i ministrit që mbulon fushën e blegtorisë.
2. Këshilli i Blegtorisë jep mendime:
 - a) për politikat bujqësore, që rregullojnë fushën e blegtorisë;

- b) për programet e zhvillimit afatgjatë;
- c) për programet racore, të paraqitura për miratim;
- ç) për raportet vjetore mbi veprimtaritë e kryera në kuadër të programeve racore;
- d) për ndryshimet në/ose futjen e metodave të reja për parashkimet e vlerës racore dhe vlerësimin e kafshëve të racës;
- dh) për rregulloret e rëndësishme në fushën e blegtorisë;
- e) për njohjen e racave autoktone;
- ë) për tarifat e shërbimeve dhe për përcaktimin e fushës së shërbimeve publike;
- f) për të ushqyerit dhe ushqimet e blegtorisë.

V. ORGANIZATAT E MIRATUARA NË BLEGTORI

Neni 75

Organizatat e mbarështimit të kafshëve të fermës

1. Organizatat e mbarështimit të kafshëve janë:
 - a) organizatat e mbarështuesve të kafshëve të racës;
 - b) organizata të specializuara.
2. Organizatat e mbarështimit të kafshëve mund të grupohen në federata ose në forma të tjera funksionimi.
3. Burimet e financimit dhe mënyra e përdorimit të fondeve bëhen në bazë të rregullave, që përcaktohen nga organizatat e mbarështimit të kafshëve.

Neni 76

Shpallja e organizatave të mbarështimit të kafshëve në Fletoren Zyrtare

1. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit boton një herë në vit në Fletoren Zyrtare listën e organizatave të mbarështimit të kafshëve, duke dhënë emrin dhe vendin, numrin dhe datën e vendimit, fushën dhe territorin e veprimit, si dhe periudhën ligjore të njohjes.
2. Ministria boton në Fletoren Zyrtare nxjerrjen nga lista të organizatave të mbarështimit të kafshëve.

A. Organizata e mbarështuesve të kafshëve të racës

Neni 77

Kërkesat për njohjen e organizatave të mbarështuesve të kafshëve të racës

1. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit miraton një organizatë të mbarështuesve të kafshëve të racës, të njohur ligjërisht si person juridik, e cila kërkon të marrë pjesë në zbatimin e një programi racor, kur:
 - a) plotëson kërkesat organizative e teknike dhe ka stafin për zbatimin e programit racor;
 - b) ka një program racor;
 - c) ka një numër të caktuar kafshësh në fermë, i cili lejon zbatimin e programit racor;
 - ç) siguron përdorimin e të dhënave të prodhimit për zbatimin e programit racor;

d) pranon dhe zbaton rregullat profesionale për përcaktimin e tipareve të racës ose racave apo populacioneve të deklaruara në librin gjenealogjik, për përcaktimin e objektivave racorë, për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve, për sistemin e grumbullimit të të dhënave të prodhimit për vlerësimin e kafshëve;

dh) ka përshtatur rregulla, që sigurojnë zhvillim të barabartë.

2. Një organizatë e mbarështuesve të kafshëve të racës, që mban librin gjenealogjik të racave autoktone, duhet të plotësojë edhe këto kërkesa:

a) specifikon racat, mbarështimi i të cilave është parashikuar brenda fushës së programit racor;
b) përshtat rregulla profesionale për identifikimin dhe regjistrimin e racave autoktone, përcakton tiparet e racave ose të populacioneve të mbajtura në librin gjenealogjik.

3. Organizata e mbarështuesve të kafshëve miratohet kur plotëson kërkesat e paraqitura në pikën 1 të këtij neni nga ajo vetë ose nëpërmjet lidhjes së një kontrate me një organizatë tjetër të miratuar, për realizimin e veprimtarive individuale teknike, të nevojshme për zbatimin e programit racor.

Neni 78

Parimet e zhvillimit të barabartë

Një organizatë mbarështuesish të kafshëve të racës, e miratuar, zbaton parimin e zhvillimit të barabartë nëpërmjet:

a) pranimit të çdo fermeri në organizatë, kur ai është i gatshëm të bashkëpunojë për zbatimin e programit racor;
b) futjes së çdo kafshe, që plotëson kriteret, në librin gjenealogjik, me kërkesë të fermerit, anëtar i organizatës.

Neni 79

Aplikimi i një organizate mbarështuesish të kafshëve të racës për njohje

Një organizatë e mbarështuesve të kafshëve të racës, përveç kërkesave të nenit 77 të këtij ligji, për njohje paraqet edhe këto të dhëna:

a) emrin, vendin dhe formën ligjore të organizatës së mbarështuesve të kafshëve të racës;
b) fushën dhe territorin e veprimit;
c) emrin dhe adresën e përfaqësuesit ligjor të organizatës së rritësve, emrin dhe adresën e personit përgjegjës për punën profesionale në zbatimin e programit racor, emrat dhe adresat e rritësve, anëtarë të organizatës ose që bashkëpunojnë me të;
ç) të dhëna për numrin e kafshëve në fermën e tyre, të përfshira në programin racor.

Neni 80

Refuzimi i njohjes

Ministri refuzon aplikimin për njohjen e një organizate mbarështuesish kur:

a) organizata nuk arrin të plotësojë kërkesat e përcaktuara në nenin 77 të këtij ligji;
b) veprimtaria e saj pengon zbatimin e programit racor të organizatës së mbarështuesve të miratuar më parë.

Neni 81

Njohja e organizatës së mbarështuesve të kafshëve të racës

1. Ministri, brenda tre muajve nga data e aplikimit, jep vendimin e njohjes ose të refuzimit të organizatës së mbarështuesve të kafshëve të racës. Vendimi jepet për një periudhë pesëvjeçare dhe përmban të dhënat e përshkruara në nenin 79 të këtij ligji.
2. Për ripërsëritjen e vendimit të njohjes, organizata e mbarështuesve të kafshëve të racës paraqet një aplikim të ri, të paktën 6 muaj përpara përfundimit të periudhës së përcaktuar në vendim.

Neni 82

Modifikimi i të dhënave

1. Përfaqësuesi i një organizate të miratuar të kafshëve të racës vë në dijeni ministrinë përkatëse për ndryshimin e të dhënave, që nënkupton emrin dhe adresën e përfaqësuesit ligjor të organizatës ose emrin dhe adresën e personit përgjegjës për punën racore profesionale në këtë organizatë.
2. Në rast të ndryshimit të programit racor dhe objektit të tij, të fushës ose territorit të veprimit, si dhe të formës ligjore të organizimit, organizata e miratuar është e detyruar të riaplikojë në ministri, duke paraqitur dokumentacionin përkatës të nevojshëm.
3. Ministri miraton ndryshimet, në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 83

Kontrolli teknik për zbatimin e programit racor të miratuar

1. Brenda tremujorit të parë të vitit kalendarik, organizata e miratuar e kafshëve të racës i paraqet Inspektoratit të Zooteknisë pranë Ministrisë një raport për zbatimin e programit racor të miratuar për vitin pararendës.
2. Kontrolli teknik për zbatimin e programit racor nga organizata e miratuar bëhet nga Inspektorati i Zooteknisë, që kontrollon dokumentacionin dhe instrumentet e organizatës së mbarështuesve të kafshëve të racës për programin racor dhe mbajtjen e librit gjenealogjik apo të regjistrit të kafshëve hibride.

Neni 84

Ndërprerja e njohjes së një organizate mbarështuesish të kafshëve të racës

1. Ndërprerja e njohjes së një organizate mbarështuesish të kafshëve të racës nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit bëhet me urdhër të ministrit kur:
 - a) organizata nuk arrin të plotësojë kërkesat e caktuara në nenet 75, 77 e 79 të këtij ligji;
 - b) organizata nuk arrin të sigurojë zbatimin e programit racor të miratuar;
 - c) ka përfunduar limiti kohor, për të cilin është nxjerë vendimi për njohjen e kësaj organizate.
2. Ministri urdhëron shtyrjen e afatit kohor të ndërprerjes së njohjes së një organizate mbarështuesish të kafshëve të racës për një periudhë, që ai e gjykon të përshtatshme.
3. Në rast se organizata e mbarështuesve të kafshëve të racës nuk arrin të shmangë mangësitë dhe çrregullimet e krijuara edhe brenda këtij kufiri kohor të caktuar, ministri, me urdhër, ndërpret njohjen e kësaj organizate.

B. Organizata e specializuar e miratuar

Neni 85

Organizata e specializuar e miratuar

1. Organizata e specializuar e miratuar është person fizik ose juridik, që plotëson kërkesat e paraqitura në këtë ligj për vendndodhjen, pajisjet dhe stafin.
2. Organizatat e specializuara të miratuara, sipas këtij ligji, janë:
Stacionet e provës, qendrat e prodhimit të spermës, qendrat e prodhimit të mbretërshave të bletëve, qendrat e prodhimit të kafshëve të racës, organizatat e grumbullimit, marrjes dhe transferimit të embrioneve, organizatat e grumbullimit të të dhënave në konkurset e kafshëve, stacionet e çiftëzimit natyror, njësitë e tregtimit të spermës dhe grupimet e ekspertëve profesionistë të blegtorisë.
3. Kërkesat e hollësishme për miratimin e organizatave të specializuara të miratuara përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 86

Anulimi i miratimit

1. Një organizatë të specializuar të miratuar i ndërpritet leja e ushtrimit të veprimtarisë kur:
 - a) nuk arrin të plotësojë kërkesat e përshkruara në këtë ligj;
 - b) nuk arrin të sigurojë, për shkak të çrregullimeve të krijuara në punë, realizimin e veprimtarisë për të cilën u miratua;
 - c) përfundon limiti kohor, për të cilin është nxjerrë vendimi për miratimin e saj.
2. Ministri, me urdhër, ka të drejtë ta shtyjë afatin kohor të ndërprejes së njohjes së një organizate, për një periudhë që ai e gjykon të përshtatshme. Në rast se organizata e specializuar nuk arrin të shmangë mangësitë dhe çrregullimet e krijuara edhe brenda këtij kufiri kohor të caktuar, ministri, me urdhër, ndërpret njohjen e kësaj organizate.

KREU VIII

TRAJNIMI DHE PUNA KËRKIMORE NË FUSHËN E BLEGTORISË

Neni 87

Trajnimi

1. Trajnimi për nevojat e blegtorisë kryhet nga:
 - a) shkollat profesionale bujqësore, shkollat e mesme bujqësore, kolegjet bujqësore;
 - b) institucionet e arsimit të lartë në fushën e bujqësisë, institucionet kërkimore në fushën e bujqësisë;
 - c) organizatat e tjera arsimore e trajnuese, programet e të cilave përfshijnë edhe mbarështimin e blegtorisë;
2. Trajnimi praktik, gjithashtu, mund të kryhet brenda fushës së veprimt nga organizatat e miratuara në blegtori.

Neni 88

Stafi profesional

1. Personat fizikë, të cilët mund të jenë inspektorë, seleksionues, mbikëqyrës, vlerësues të kafshëve, që bëjnë trajnimin profesional, sipas këtij ligji, duhet të kenë diplomë universitare ose njohuri dhe përvojë, por jo më pak se 5 vjet në fushën e blegtorisë.
2. Personat fizikë, që sigurojnë veprimtari të specializuara profesionale, sipas këtij ligji, të tilla si menaxhimin e realizimit të programeve racore, parashikimin e vlerave racore të kafshëve, procedurat e provës dhe të tjera të këtij niveli, duhet të kenë diplomë universitare dhe përvojë në fushën e zooteknisë dhe, nëse është e nevojshme, edhe nga ndonjë fushë tjetër e ngjashme, duke iu nënshtruar më parë vlerësimit të njohurive profesionale.
3. Vlerësimi i njohurive profesionale bëhet nga një komision, i cili ngrihet me urdhër të ministrit. Kriteret për vlerësimin e njohurive profesionale bëhen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
4. Përmbajtja e detyrueshme, niveli minimal i programeve të trajnimit profesional, procedurat dhe metodat e vlerësimit e të kontrollit të njohurive, si dhe libri i regjistrimit të personave, që u janë nënshtruar vlerësimit të njohurive profesionale, përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 89

Instituti i Kërkimeve Zooteknike

1. Në kuadër të programeve kombëtare të bujqësisë dhe të zhvillimit rural, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me ministrinë e tjera, financon ose bashkëfinancon projektet dhe infrastrukturën kërkimore në fushën e blegtorisë.
2. Instituti i Kërkimeve Zooteknike, Instituti i Kërkimeve të Bimëve të Arave dhe institutet e tjera të specializuara janë struktura të kërkimit shkencor në blegtori.
3. Instituti i Kërkimeve Zooteknike kryen kërkimin shkencor dhe transferimin e teknologjive në fushën e prodhimit blegtoral në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
4. Instituti i Kërkimeve Zooteknike është qendër reference për kontrollin e ushqimeve, që përdoren në blegtori dhe për kontrollin e spermës, të vezëve dhe embrioneve.
5. Instituti i Kërkimeve Zooteknike realizon veprimtarinë kërkimore-shkencore në zbatim të politikave të zhvillimit të prodhimit blegtoral.
6. Transferimi i rezultateve të kërkimit në praktikën blegtorale bëhet nga institutet kërkimore-shkencore, nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, nga shërbimi këshillimor bujqësor dhe nga ekspertët profesionistë në fushën e blegtorisë.

KREU IX

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 90

Kundërvajtjet administrative

1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë shkeljet e mëposhtme:
 - a) mbarështimi i kafshëve të fermës, i cili nuk kryhet sipas kërkesave të përshkruara në nenet 4, 5, 7, 9, 11, 16, 17 e 19 të këtij ligji;
 - b) administrimi i burimeve të mjaltit në kundërshtim me nenin 20 të këtij ligji;

- c) mosmbajtja e regjistrave, e dokumenteve zooteknike dhe e dokumenteve të tjera, sipas rregullave të përcaktuara në nenet 22 e 29 të këtij ligji;
 - ç) mospërdorimi i etiketave për produktet blegtorale, në kundërshtim me nenin 25 të këtij ligji;
 - d) mbajtja e librave të racës ose të tjera të kësaj natyre në kundërshtim me nenin 32 të këtij ligji;
 - dh) përcaktimi si kafshë riprodhuese me vlera racore e një kafshe, që nuk arrin të plotësojë kriteret e përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji;
 - e) përdorimi i riprodhuesve të kafshëve meshkuj në kundërshtim me nenin 38 të këtij ligji;
 - ë) tregtimi ose përdorimi i spermës në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në nenet 39, 62 dhe 64 të këtij ligji;
 - f) tregtimi dhe përdorimi i vezëve dhe i embrioneve në kundërshtim me nenet 40 dhe 63 të këtij ligji;
 - g) mosmatja e tipareve të kafshëve bujqësore në stacionet e miratuara të provës, sipas kërkesave të neneve 43 dhe 47 të këtij ligji;
 - gj) mosmbajtja e dokumentacionit në përputhje me programin racor të përcaktuar në nenin 48 të këtij ligji;
 - h) veprimtaria e inseminimit artificial në kundërshtim me nenet 49, 50, 51 dhe 53 të këtij ligji;
 - i) veprimtaria e qendrave të prodhimit të spermës, të riprodhimit dhe të materialit racor në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në nenin 54 të këtij ligji;
 - j) tregtimi i kafshëve të racës dhe i materialit racor në kundërshtim me nenet 61 dhe 62 të këtij ligji;
 - k) importimi dhe/ose eksportimi i materialit racor në kundërshtim me nenin 64 të këtij ligji.
2. Personat fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e blegtorisë, janë të detyruar të lejojnë inspektorët e zooteknisë të kontrollojnë zbatimin e detyrimeve, që rrjedhin nga ky ligj. Inspektorit i vihen në dispozicion dokumentet e kërkuara me të dhënat, shpjegimet dhe objektet e nevojshme.
3. Personat fizikë dhe juridikë, brenda një kufiri kohor të caktuar, procedojnë, në përputhje me vendimin e inspektorit të zooteknisë, për zbatimin e masave të parashikuara në këtë ligj.
4. Pengimi i inspektorëve për kryerjen e detyrës, mosparaqitja e dokumenteve, e të dhënave dhe e shpjegimeve të kërkuara personave fizikë dhe juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë në fushën e blegtorisë, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga 20 000 (njëzet mijë) lekë deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

Neni 91

Procedura e dhënies së masës administrative

1. Të drejtën e dhënies së masës administrative e ka inspektori i zooteknisë.
2. Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtën e ankimit pranë Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për masën e vendosur nga inspektorët e zooteknisë, brenda 15 ditëve nga dhënia e saj. Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankesës me shkrim.
3. Kundër vendimit të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mund të bëhet ankimim në gjykatën e rrethit gjyqësor ku është kryer kundërvajtja, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit të vendimit.

Neni 92

Ekzekutimi i vendimit

Ekzekutimi i vendimit kryhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në nenet 19 e 20 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

KREU X

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 93

Riprodhuesit meshkuj

Deri në hyrjen në fuqi të akteve nënligjore, të dala në zbatim të këtij ligji, për riprodhuesit meshkuj do të zbatohen masat e përcaktuara në ligjin nr. 8409, datë 29.9.1998 “Për riprodhuesit racëpastër dhe tufat racore në blegtori” dhe në rregulloret e nxjerra në zbatim të tij.

Neni 94

Vlerësimi nga pasardhësit

Përdorimi i riprodhuesve meshkuj, të pavlerësuar nga pasardhësit nga qendrat e prodhimit të spermës për gjedhë, lejohet për një afat prej shtatë vjetësh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 95

Stacionet e provës, qendrat e prodhimit e të kontrollit të materialeve racore

Stacionet e provës, qendrat e prodhimit të spermës, stacionet e çiftëzimit natyror dhe të inseminimit, qendrat e prodhimit të kafshëve të racës, qendrat prindërore të shpendëve, qendrat e prodhimit të mbretërshave të bletëve, të cilat ekzistojnë, duhet ta përshtasin veprimtarinë e tyre me rregullat e përcaktuara në këtë ligj, jo më vonë se 2 vjet nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 96

Kompetenca profesionale të mbarështuesve

Për sa i përket nivelit të njohurive profesionale, mbarështuesit aktualë të kafshëve të fermës njësohen me kërkesat, që përcaktohen në nenin 12 të këtij ligji.

Neni 97

Hartimi i akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 56, 58, 60 e 73 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, 6, 7, 15, 16, 17, 19, 20, 21, 22, 24, 26, 29, 32, 33, 35, 39, 40, 43, 46, 48, 53, 54, 55, 56, 57, 60, 61, 64, 69, 72, 85 e 88 të këtij ligji.

Neni 98

Shfuqizime

Ligji nr.7627, datë 21.10.1992 “Për shërbimin zooteknik” dhe ligji nr. 8409, datë 25.09.1998 “Për riprodhuesit racëpastër dhe tufat racore në blegtori”, si dhe nenet 3 pika 12, 8 pika 3, 12 e 13 të ligjit nr. 8411, datë 1.10.1998 “Për ushqimet e blegtorisë”, shfuqizohen.

Neni 99

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R E

Jozefina Topalli (Çoba)